



Falsifikime në emër të Pjetrit në Krishterim

Description

Bart D. Ehrman

Fragment i shkëputur nga lib i Bart D. Ehrman-it me titull: “Forged: Writing In The Name Of God – Why The Bible’s Authors Are Not Who We Think They Are” (Harper One, 2011).

Deri tani, në diskutimin tim të gjënjeshtrave të hershme, mashtrimeve dhe falsifikimeve unë kam përdorur termin “e vërtetë” në një kuptim shumë të thjeshtë, në kuptimin e diçkaje të ngjashme me “një informacion të saktë”. Ndonëse në të fakt e vërteta dhe e kundërta e saj, e pavërteta, janë të ndërlikuara. Mendoj se thellë thellë ne të gjithë e kuptojmë këtë, ndonëse nuk i kemi kushtuar shumë vëmendje. Kur shohom një film shpesh pyesim: “A është kjo një histori e vërtetë”? Me këtë dëshirojmë të themi: “A është kjo diçka që ka ndodhur vërtetë”? Nëse përgjigja është po, atëherë në një farë mënyrë ndjehemi të siguar dhe të qetësuar që ngjarjet kanë ndodhur me të vërtetë dhe për pasojë, si një histori, ajo është më e “vërtetë” se ato të trilluara. Por edhe në këtë rast nuk besojmë asnjëherë se absolutisht gjithçka që gjendet në film – të gjithë karakteret, dialogjet, skenat e veçanta, etj. – është absolutisht dhe tërësisht në përputhje me mënyrën se si kanë rrjedhur “vërtetë” ngjarjet. Ne lejojmë mundësinë e një lloji lirike poetike të shtrembërimit, madje edhe në rastet kur pranojmë se historia është deri diku e “vërtetë”.

Mund lehtësisht të pohojmë se një film mund të jetë i vërtetë, në një kuptim të thellë, madje edhe kur flet për diçka që nuk ka ndodhur asnjëherë. Kjo ka qenë pikëpamja ime për vite me rradhë dhe ajo i luante mendësh fëmijët e mi kur ishin të vegjël. Ne shihnim një film dhe ata thonin “Baba, a është e vërtetë kjo histori?”. Unë pothuajse gjithnjë i thoja po. Por menjëherë ata e kujtonin që unë priresha të kisha një pikëpamje tjetër të gjërave dhe vazhdonin me pyetjen: “Jo babi, unë dua të them se a ka ndodhur vërtetë kjo? Atëherë unë i thoja jo dhe ata vazhdonin të qëndronin në mëdysheje.

Kështu mund të ndjehen edhe disa prej lexuesve të mi. Si mund të jetë “e vërtetë” një histori kur nuk ka ndodhur në të vërtetë. Në fakt, nëse mendojmë paska më thellë mund të themi se ekzistojnë gjithëfarëlloj historish të vërteta që nuk kanë ndodhur, siç mund të pranohet nga të gjithë. Kur unë përpiqem t’ia shpjegoj këtë studentëve të mi zakonisht i tregoj historinë e Xhorxh Uashingtonit dhe pemës së qershisë.

Histori e vërtetë që nuk kanë ndodhur asnjëherë

Në Amerikë, çdo nxënës i shkollës fillore e njih historinë e pemës së qershisë. Si një djalë i ri, Xhorxh Uashingtoni, për arsye të panjohura, iu vërsul pemës së qershisë së babait të tij. Kur babai u kthye në shtëpi, ai vështroi pemën dhe pyeti: “Kush e ka prerë pemën time të qershisë?” Xhorxhi i vogël iu përgjigj: “Unë nuk mund të gënjej, atë e bëra unë.” Nga mënyra se si rrëfëhet zakonisht kjo histori nuk thuhet asgjë rreth asaj që ndodhi më pas.. Historia përfundon me fjalinë e Xhorxhit të cilën sapo e përmendëm^[1].

Ne e dimë që kjo histori nuk ka ndodhur asnjëherë, sepse personi që trilloi këtë histori e ka pranuar këtë më pas. Ai ishte një pastor i krishterë i quajtur Mason Locke Ëeems, i njohur si Parson Ëeems. Si një biograf i mëvonshëm i Xhorxh Uashingtonit, Parson Ëeems rrëfeu se ai e kishte trilluar historinë, ndonëse më parë kishte deklaruar se e kishte marrë atë nga dëshmitarë okularë të besueshëm (çfarë paradoksi: “ai tregoi një gënjeshtër” në këtë histori që flet rreth mos të gënjerit).

Këtu kemi një histori që e dimë që nuk është historike, por ende vazhdojmë t’ia tregojmë atë fëmijëve tanë. Përse e bëjmë këtë? Jo sepse përpiqemi t’i mësojmë në lidhje me faktet e historisë koloniale, por sepse mendojmë se historia përçon “një të vërtetë” që duam që fëmijët tanë ta mësojnë. Pretendimet për të vërtetën e kësaj historie vepron, në të vërtetë, në disa nivele. Në një nivel kjo histori është një copëz e mirë propagande politike për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kush ishte Xhorxh Uashingtoni? Ai ishte babai i kombit tonë. Ç’lloj personi ishte ai? Ai ishte një njeri i ndershëm, një njeri që nuk do të thoshte asnjëherë një gënjeshtër. Me të vërtetë? Sa i ndershëm ishte ai? Po ja, një ditë kur ai ishte fëmijë...Përfundimi është i qartë. Ky komb nuk mund të thotë një gënjeshtër. Ose së paku kështu thotë historia.

Por historia e Xhorxh Uashingtonit dhe pemës së qershisë funksionon, gjithashtu, edhe në një tjetër nivel dhe ndoshta kjo është arsyeja përse shumica e prindërve janë të kënaqur që fëmijët e tyre ta mësojnë atë. Kjo është një histori rreth përgjegjësisë dhe moralit personal. Unë ia kam treguar këtë histori fëmijëve të mi sepse doja që ata të ishin si Xhorxh Uashingtoni i vogël. Madje edhe nëse ata kishin bërë ndonjë gjë të gabuar, unë doja që ata të tregoheshin të sinqertë dhe të tregonin të vërtetën. Është më mirë të tregohesh i sinqertë dhe të përballesh me pasojat se sa të jetosh një jetë pandershmërie. Është mirë që të mos thuash gënjeshtër.

Ajo që dua të them është se një trill, madje edhe një trill historik, në një farë kuptimi mund të përçojë një të “vërtetë”, ndonëse është diçka që nuk ka ndodhur asnjëherë. E vërteta është më shumë se sa thjesht një informacion i saktë.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se nuk ekziston e pavërteta. Përkundrazi, ekzistojnë mjaft lloj pavërtetësish: informacion i pasaktë, mashtrimi i hapur, histori që përcjellin mesazhe që *nuk* i pranojmë si të “vërteta” bazuar mbi kuptimin tonë të botës.^[2] Nëse do të lexonim histori rreth fëmijërisë së Stalinit, të cilat theksojnë prirjen e tij qenësisht të ëmbël, natyrën e tij të dashur dhe xhentile, dhe preokupimin e tij të thellë për mirëqenien e të tjerëve, unë do të thoja se kjo histori është e pavërtetë.

Edhe njerëzit e lashtë kishin, gjithashtu, një ndjenjë të nuancuar të së vërtetës dhe gënjeshtërisë. Edhe ata kishin histori që i pranonin si në një farë mënyre të “vërteta”, pa besuar se ato kanë ndodhur me të vërtetë.^[3] Shumica studiuesve në ditët tona pranojnë se shumica e njerëzve të edukuar në greqinë e lashtë dhe në Romë nuk besonin në mënyrë të fjalëpërfjalshme se historitë rreth zotave kishin ndodhur në të vërtetë në mënyrë historike. Ato ishin histori që kishin si qëllim të përçonin një farë kuptimi të vërtetë të sferës hyjnore dhe marrëdhënies njerëzore me të. Edhe njerëzit e lashtë kishin ekuivalentin e trillimeve moderne. Është e vërtetë, siç kanë theksuar disa studiues, se nocionet moderne të trillit janë shumë më të sofistikuara dhe më me ngjyrimë se çdo gjë që mund të hasim në lashtësi. Por, përveç miteve, njerëzit e lashtë kanë pasur poema epike, legjenda dhe novela (ndonjëherë të quajtura “romanca”, të cilat në shumë mënyra i korrespondojnë formave të narrativës fikson të ditëve tona. Njerëzit nuk i rrëfenin e stërrëfenin, lexonin dhe recitonin këto forma trilli thjesht sepse mendonin se ishin fjalëpërfjalë të vërteta, por i lexonin pothuajse për të njëjtën arsye që i lexojmë sot: për dëfrim, për të mësuar diçka, për t’i ndihmuar ato që të kuptonin më mirë veten dhe botën.

Nocioni i “trillimit” (fiksonit) është shumë tërheqës. Nëse lexojmë një libër që deklaron se është një biografi e autorizuar e Ronald Reganit, presim që ai t’i qëndroj besnik fakteve dhe të mos përcjellë informacion historikisht të pasaktë. Por, nëse lexojmë një novelë rreth një presidenti të Shteteve të Bashkuara të Amerikës të viteve tetëdhjetë – një libër që e reklamon veten si trillim i pastër – do të presim një farë besueshmërie historike (presidenti nuk duhet treguar sikur vozit në internet apo shqyrton murin (ëall) e tij në facebook), por ne nuk presim që kjo novelë të na ofroj fakte të vërteta historike në lidhje me një person të vërtetë historik. Veprat e lashta ekuivalente me ato të trillimeve moderne funksionin në mënyrë të ngjashme. Lexuesit prisnin që rrëfimi të kishte një farë kuptimi nga ana historike – pra, të ishte bindës – por ato nuk prisnin që historia të përputhej me faktet e realitetit historik.

Natyrisht, dallimi midis një biografie moderne dhe një novele moderne është një çështje që i përket zhanreve letrare. Shkollarët kanë pasur debate të gjata rreth asaj se çfarë kuptimi ka në të vërtetë nocioni i “zhanrit”, por për qëllimin tonë unë mendoj se një shpjegim i përgjithshëm dhe i lehtë do të ishte mëse i mjaftueshëm. Një zhanër është një “lloj” të shkruari që përmbush disa pritshmëri në formë. Për shembull, një histori e shkurtër është e shkurtër, ndërsa një novelë është e gjatë. Të dyja kanë karaktere dhe intriga dhe tipare të tjera të përbashkëta që i bëjnë ato të ndryshme nga një haik. Një poemë humoristike pesëvargëshe ka një rimë të mençur dhe një varg çuditërisht thumbues. Vargjet e lira nuk kanë asnjë nga këto karakteristika, por mbështeten në thellësinë e gjuhës për të përcjellë kuptimin. E kështu me rradhë. Karakteristikat e secilit lloj zhanri paraqesin një lloj marrëveshjeje të nënkuptuar midis autorit dhe lexuesit. Ai është pothuajse një marrëveshje kontraktuale, në të cilën autori ofron atë që pritet për këtë lloj të të shkruarit dhe lexuesit nuk duhet të presin asgjë tjetër nga ajo që ndodh zakonisht në këtë lloj të të shkruari.

Kur vjen fjala tek trillimi, pothuajse në të gjitha format e tij, lexuesit pajtohen që ta pezullojnë gjykimin në lidhje me saktësinë historike të detajeve të treguara, ndërkohë që do të presin që vepra të jetë

historikisht e besueshme^[4] Arsye përse funksionojnë veprat e fikcionit (trillimit) është se, për hir të dëfrimit, lexuesit janë të gatshëm të bëjnë këtë marrëveshje të heshtur me autorin.

Megjithatë, kur vjen fjala tek biografia apo shkrimi historik lexuesit nuk e bëjnë këtë marrëveshje. Në këtë rast autori pajtohet që t'i qëndroj besnik fakteve historike që aq sa mundet dhe lexuesit presin prej tij që ai të bëjë pikërisht këtë.

Për sa i përket shkrimeve historike të lashta yshtja është pak më e ndërlikuar. Në pjesën më të madhe kjo vjen për shkak të faktit se në lashtësi nuk ekzistonin mjetet kërkimore të ditëve tona, d.m.th. akses të gjerë në burime të besueshme, regjistrime të bollshme të shkruara, baza të të dhënave, sisteme të marrjes së të dhënave dhe mundësitë që na jepen nga masmedia dhe format elektronike të komunikimit. Historianët e lashtë duhej të përdornin të gjitha mundësitë për të mbledhur së bashku një narrativë të besueshme të ngjarjeve të kaluara. Në të vërtetë, ishte shumë e vështirë të ofroje një rrëfim “të saktë”, ndonëse shumica e historianëve përpiqeshin të bënin një gjë të tillë. Disa prej historive më të mira nga lashtësia janë të mbushura plotë e përplot me fjalime të bëra nga personazhet kryesore. Por, nëse ngjarjet kishin ndodhur dekada ose shekuj më herët, në një periudhë para se të ekzistonin kasetat e regjistrimit, apo stenografët dhe raportimet ditore, si mund të dinte një historian se çfarë kishte thënë në të vërtetë personazhi? Në fakt, nuk kishte asnjë mënyrë verifikimi.

Për këtë arsye një historian madhështor, si historiani i famshëm i shekullit të V (p.e.s.) Thucididi pohon qartësisht se ai thjesht i kishte shpikur vetë fjalimet. Çfarë alternative kishin historianët e lashtë? Më e mira që mund të bënin ishte të shpiknin një fjalim që i dukej i përshtatshëm për karakterin e folësit, rastin dhe besimin se kjo ishte pak a shumë një përafrim i asaj që ai kishte thënë në të vërtetë. Nuk ekzistonte asnjë mënyrë për të vërtetuar nëse historiani kishte thënë të vërtetën. Por lexuesit e edukuar e kuptonin që kjo ishte ajo që bënin historianët, këtu kemi sërish një lloj kontrate të nënkuptuar midis autorit dhe lexuesit. Autori do të vinte me hamendësimin më të mundshëm në lidhje me atë që kishte thënë folësi dhe lexuesi do ta pranonte atë për atë që ishte, hamendja më e mirë.

Disa shkollarë kanë menduar se falsifikimi ishte i ngjashëm me këtë, një lloj trillimi i krahasueshëm me shpikjen e fjalimeve në histori, në të cilin autori i vërtetë dhe lexuesi i vërtetë bien dakord që të mos e marrin seriozisht emrin që i ngjitet një shkrimi. Siç do të tregoj në vijim, studiuesit e vonshëm që kanë studiuar diskutimet e hershme në lidhje me falsifikimet tregojnë se ky mendim nuk është i saktë. Falsifikimet ishin tekste letrare në të cilin autori adoptonte një lloj trillimi *pa* lejen e lexuesve. Kur lexuesit e kuptonin këtë nuk e vlerësonin aspak. Njerëzit e lashtë i trajtonin narrativat historike të falsifikuara, traktatet, letrat, etj., si “shkrime të pavërteta” dhe “gënjeshtra” dhe jo si një lloj trillimi të padëmshëm dhe të pafajshëm. Kjo ishte arsyeja përse njerëzit e lashtësisë ishin kaq të interesuar në kuptonin nëse librat ishin “bij autentikë” të autorëve apo “të paligjshëm”, që nuk i përkisnin në të vërtetë personit të përmendur në libër.

Kësisoj, edhe njerëzit e lashtë e njihnin dallimin midis rrëfimeve të sajura fiktive dhe narrativës historike. Disa historianë, si Luciani i Samosata-s dhe Polibiusi, ndryshe nga Thucididi, ishin shumë këmbëngulës në faktin që tregimet historike duhet të tregonin vetëm atë që kishte ndodhur në të vërtetë. Historianët nuk duhej t'i trillonin historitë apo madje edhe fjalimet e mbajtura nga personazhet e historive të tyre. Siç ka thënë në mënyrë të përmbledhur edhe Polibiusi, një historian grek i shekullit të II (p.e.s), i cili ka shkruar rreth ngjithjes së Romës në pushtet, historiani “duhet të regjistroj thjesht atë që ka ndodhur dhe është thënë në të vërtetë” Për Polibiusi, historiani është i ndryshëm nga “poeti tragjik” (d.m.th. autori i dramës fiktive): “Poeti tragjik duhet të emocionoj dhe magjepsë për momentin

audiencën e tij përmes vërtetësisë në dukje të fjalëve që i vendos në gojën e karaktereve të tij, por është detyra e historianit që të instruktoj dhe bindë për çdo kohë studentët seriozë, përmes të vërtetës së fakteve dhe fjalimeve që rrëfen”.[\[5\]](#)

Natyrisht, arsyeja përse një historian si Polibiusi duhej të argumentonte këtë pikë me kaq zell është fakti se historianë të tjerë bënë pikërisht atë që ai kundërshtonte, shpiknin sipas dëshirës fjalime, madje edhe rrëfime për tregimet e tyre “historike”. Është padyshim e vërtetë se jo vetëm historianët por edhe njerëzit në përgjithësi shpiknin shumë histori rreth figurave historike. Në rrethet e krishtera kjo ka ndodhur pothuajse për çdo figurë historike të rëndësishme që njohim, për Jezusin, Palin, Pjetrin dhe anëtarët e tjetër të grupit apostolik. Në këtë kapitull, duke qenë se unë jam i interesuar në librat që pretendojnë se janë shkruar nga Pjetri, por në vërtetë janë falsifikime në emër të tij, le të fillojmë duke marrë në konsideratë disa nga historitë e shpikura rreth tij, para se të analizojmë librat që i atribuohen atij në mënyrë të pavërtetë.

Historitë rreth Pjetrit

Ne kemi në dorë disa libra nga koha e krishterimit të hershëm që rrëfejnë histori rreth Pjetrit. Këto histori ishin pothuajse gjithnjë tërësisht “të shpikura” nga ndonjë tregimtar i krishter. Sipas përkufizimeve të dhëna nga unë këto histori nuk janë falsifikime, ato nuk janë rrëfime që pohojnë në mënyrë të gënjeshtërt se janë shkruar nga Pjetri. Në vend të kësaj, ato mund të quhen “sajesa”, historia të shpikura *rreth* Pjetrit.[\[6\]](#)

Një nga historitë me interesante haset në një dokument të falsifikuar. Megjithatë, ky falsifikim nuk është bërë në emër të Pjetrit, por në emër të Titit, shokut të Palit. Dhjata e Re përmban një letër që pretendon se është shkruar nga Pali, i cili ia ka drejtuar atë Titit, për të cilën në kapitullin e tretë të këtij libri unë do të argumentoj se është një letër pseudonome (d.m.th. e falsifikuar në emër të Palit). Rreth katërqind vjet më vonë shfaqet një tjetër letër e cila pretendon se është shkruar nga Titusi. Ajo është një letër intriguese, sepse ajo mbron fuqimisht idenë se e vetmja mënyrë për të pasur jetën e përjetshme është duke jetuar një jetë të përkorë, asketike. Që ta themi copë, dikush mund të siguroj shpëtimin vetëm duke u përmbajtur nga marrëdhëniet seksuale. Në kontekstin e këtij diskursi të falsifikuar, autori i kësaj letre citon një histori rreth Pjetrit që shërben për të ilustruar këtë pikë.

Një fshatar e sjell vajzën e tij të virgjër për bekim tek Pjetri. Pjetri bën një lutje për vajzën duke i kërkuar Zotit të bëj më të mirën për të. Ajo bie shakull e vdekur në tokë. Natyrshëm babai i vajzës pikëllohet, por autori i letrës e quan atë “mosbesues”, sepse ai nuk beson se ajo që i ndodhi vajzës ishte në të mirën e saj. Ai i lutet Pjetrit që ta kthej vajzën në jetë dhe Pjetri e bën këtë. Por, disa ditë vizitori që pretendon se është i krishterë vjen për të qëndruar me fshatarin dhe e josh vajzën e tij. Ata arratisen së bashku dhe nuk shihen më. Ky është fundi i historisë. Në kontekstin e letrës, mesazhi është tejet i qartë: është më mirë të jesh i vdekur se sa të tërhiqesh drejt dëshirës seksuale.

Një rrëfim i ngjashëm mund të gjendet edhe në një përmbledhje historish rreth aktiviteteve misionare të Pjetrit, të cilat me shumë mundësi janë shkruar në shekullin e dytë pas Krishtit. Rrëfimi, i cili quhet

thjesht me emrin “Aktet e Pjetrit”, përshkruan mrekullitë e mëdha të kryera nga Pjetri pas ringjalljes dhe ngjitjes në qiell të Jezusit, ku ai demonstroi fuqinë e Zotit të ringjallur dhe konvertoi persona të shumtë në besim.

Në një nga historitë, Pjetri paraqitet duke i folur një grupi të krishterësh në shtëpinë e tij ditën e Dielë. Ata kanë sjellë me vete një grup njerëzish të sëmurë në mënyrë që ai t'i shëroj. Por, dikush nga turma e pyet Pjetrin se përse ai nuk dëshironte ta shëronte vajzën e tij, e cila qëndronte e paralizuar në një cep të shtëpisë. Pjetri e siguron mysafirin e tij se nëse Zoti dëshiron, Ai ka fuqinë për ta shëruar vajzën. Për ta provuar këtë, Pjetri e urdhëroi vajzën të ngihet dhe të ecë natyrshëm. Dhe ajo e bënte. Turma është njëherazi e mahnitur dhe e trallisur.

Atëherë Pjetri rrëfen historinë e vajzës së tij. Kur ajo ishte e re, Pjetri mëson përmes një vizioni nga Zoti se nëse ajo do të qëndronte mirë me shëndet atëherë ajo do të dërgonte në humbje shumë njerëz. Me sa duket ajo ishte një fëmijë i bukur dhe kur të rritej ajo do të nxiste shumë burra që të flinin me të. Kur ajo ishte dhjetë vjeç, një fqinj i afërt tentoi ta joshte atë, por para se ai të bënte marrëdhënie seksuale me të, falë mëshirës së Zotit, ajo u paralizua. Për shkak të telasheve që shkaktoi, fqinji u verbua, derisa u shërua nga Pjetri dhe u konvertua në Krishterim. Por, vajza duhej të mbetej e paralizuar, në mënyrë që të mos dërgonte njerëz të tjerë në humbje. Këtu sërish çështja është përsosmërisht e qartë: seksi është i rrezikshëm dhe duhet evituar me çdo kusht, madje edhe nëse kjo do të thoshte të kaloje një jetë si invalid.

Vepra “Aktet e Pjetrit” është qartësisht e ndërtuar rreth një serie diskutimesh ndërmjet Pjetrit, si përfaqësues i Zotit të vërtetë, dhe një heretiku të quajtur Simon, një magjistar i fuqizuar nga djalli. Secili prej tyre mund të bëjë mrekullira dhe secili përpiket të bind turmat se është ai, dhe jo tjetri, që zotëron të vërtetën. Një prej mrekullive flet për Pjetrin dhe tonin e tymosur. Në rrëfim na thuhet se Pjetri po përpiquej të bindte turmat dhe nuk po arrinte sukses. Ai ishte duke qëndruar pranë dyqanit të një shitësi peshku dhe vështronte një peshk ton të tymosur që varej në dritare. Ai e pyeti turmën se a do të besonin nëse ai do ta sillte në jetë peshkun e vdekur. Po, thana ata, pas kësaj ata do të besonin. Kështu që, ai e hoqi tonin nga kanxha, e hodhi atë në një haur aty afër dhe e urdhëroi tonin që ngjallej. Peshku u ngjall – jo vetëm për pak minuta – për së vërteti. Turma u kënaq dhe besoi.

Mrekulli më të mëdha presin ende për tu treguar. Pjetri dhe Simoni Magjistari thërriten për të garuar në arenë nga zyrtari lokal romak, në mënyrë që të shihej se kush ishte përfaqësuesi i vërtetë i Zotit. Një djalosh skllav sillet në arenë. Simoni udhëzohet që ta vrasë atë dhe Pjetri ta ngjallë nga të vdekurit. Simoni flet një fjalë në veshin e djalit dhe ai bie shakull i vdekur (është heretiku që flet fjalën e vdekjes). Por, Pjetri i thotë pronarit të djalit që t'ia kapë dhe t'ia ngrejë dorën djalit dhe djalit i restaurohet menjëherë jeta (njeriu i Zotit ka fjalën e jetës).

Më pas një grua e pasur vjen tek Pjetri dhe i lutet që ta ndihmojë edhe atë. Djali i saj kishte vdekur dhe ajo dëshironte dëshpërimisht që Pjetri ta kthente përsëri në jetë. Pjetri e sfidoi Simonin në duel për të parë se kush do ta ngjallte djalin. Ndërkohë që turma po shikonte, Simoni kryen një seri mashtrimesh: duke qëndruar pranë trupit të vdekur, ai bie dhe ngrihet tre herë, dhe ja, njeriu i vdekur gren kokën e tij. Turma bindet që Simoni është fuqia e vërtetë e Zotit, kështu që Pjetri duhet të jetë një mashtrues. Ata përpiqen ta djegin atë në turrën e druve, por Pjetri i bërtet atyre dhe tregon se Simoni nuk e ka ngjallur vërtet djalin prej së vdekuri. Ai thjesht lëvizti kokën e tij. Nëse Simoni vjen vërtet prej Zotit, ai duhet të jetë i aftë ta ngrejë dhe ta bëjë të eci djalin. Kur Simoni nuk arriti ta bënte këtë, atëherë rradha i erdhi Pjetrit. I foli një fjalë e ngriti djalin plotësisht në këmbë dhe e bëri të fliste. Që nga ajo kohë njerëzi e

“nderuan Pjetrin si një zot”.

Kulmi i historisë vjen kur heretiku Simon i bën të ditur turmës se ai do ta provojë superioritetin e tij duke fluturuar si zog mbi kodrat dhe tempujt e Romës. Kur erdhi dita e aktit të tij heroik ai e mbajti fjalën dhe u ngrit duke fluturuar si zog. Në mënyrë që të mos mposhtej, Pjetri thërret në ndihmë Zotin dhe ia heq forcën Simonit ndërsa ai ishte në mes të fluturimit. Ai bie në tokë dhe thyen këmbën. Turma konvergon tek ai dhe e gurëzon për vdekje si një mashtrues. Është Pjetri ai që ka fuqinë e vërtetë të Zotit.

Histori si këto mund të shumëfishohen me lehtësi. Në të vërtetë, ato *shumëfishoheshin* duke qenë se, në shekullin e dytë dhe të tretë, rrëfimet e krishterë sajnin rrëfime legjendare për heronjtë e mëdhenj të besimit. Kështu që, ata shpikën histori *rreth* Pjetrit. A kanë shpikur ata edhe shkrime *duke i hequr* si të Pjetrit? Edhe në lidhje me këtë duket se nuk ka asnjë dyshim. Në një masë jo të vogël kjo ka ndodhur për të njëjtat arsye që kemi parë derimëtanë. Të krishterë të ndryshëm kishin presupozime, botëkuptime, praktika dhe teologji konkurruese, të cilat kishin nevojë për “autoritet” apostolik që t’i mbështeste. Një shkrim në emër të Pjetrit mund të autorizonte një grup pikëpamjesh, në emër të një “autoriteti” më të madh, i cili konsiderohej si “autori” i shkrimit. [...]

Shkrimet e “Pjetrit” që shfaqen në Dhjatën e Re

Librat për të cilat kemi folur gjerësisht – Aktet e Pjetrit, Ungjilli sipas Pjetrit, Shkrimet pseudo-klementine, Apokalipsi i Pjetrit – nuk janë të vetmet sajesa *rreth* Pjetrit dhe as të vetmet falsifikime gjoja të shkruara *nga* Pjetri që janë shfaqur në kishën e hershme. Ekzistonin edhe shkrime të tjerë, “Akte” të tjera të Pjetrit, një përmbledhje e quajtur “Predikimi” i Pjetrit, si edhe dy apokalipse të tjera. Askush nuk e di me sa saktësi se sa vepra të tjera të tilla kanë ekzistuar. Prodhimi i librave në emër të Pjetrit ishte diçka shumë e përhapur në kishën e hershme.

A është e mundur, nën dritën e këtij përdorimi të gjerë të emrit të Pjetrit për të autorizuar pikëpamje specifike [të njerëzve në kishën e hershme], që ndonjë falsifikim në emër të Pjetrit të ketë hyrë edhe në Dhjatën e Re? Siç dihet, në Dhjatën e Re ekzistojnë dy libra që mbajnë emrin e Pjetrit, ato janë 1 dhe 2 Pjetri. Të dyja libra deklarojnë të jenë shkruar nga Pjetri, por ekzistojnë arsye të fota për të menduar se Pjetri nuk ka shkruar asnjë prej tyre.

1 Pjetri

Libri i 1 Pjetrit pretendon të jetë shkruar nga “Pjetri, një apostull i Jezu Krishtit”, për të krishterët, që ai i quan “të mërguar”, në pesë provincat e pjesës perëndimore të asaj që tani është Turqia.^[7] Nuk ka asnjë dyshim se autori i këtij libri pretendon se është Pjetri, dishepulli më i ngushtë i Jezusit. Pjetri nuk ishte emri i tij personal, por ai i ishte vënë atij nga Jezusi. Sipas ungjijve, emri i vërtetë i këtij dishepulli ishte Simon. Por Jezusi tregoi se ai do të ishte “guri” (greqisht *petros*) mbi të cilin do të themelohej Kisha. Kështu që, Jezusi e quajti atë “Guri”, ose “Pjetër” (Shih Matteu 16:13-18).^[8] Me aq sa dimë,

askush tjetër nuk është quajtur Pjetër, derisa më vonë të krishterët filluan t'i vendosnin bijve të tyre emrin e apostullit të madh. Kështu që, autori i 1 Pjetrit pretendon, pa dyshim, të jetë pikërisht Pjetër apostulli. Kjo kuptohet nga komenti i tij në pasazhin 5:1, ku pohon se ai ka qenë personalisht një “dëshmitar i vuajtjeve të Krishtit.”^[9] Çështja e vuajtjes është tema qendrore e librit. Në fakt, fjala “vuajtje” haset më shumë në këtë letër të shkurtër prej pesë kapitujsh se sa në çdo libër tjetër të Dhjatës së Re, përfshi edhe ungjijtë, të cilët janë shumë më të gjatë se sa kjo letër. Autori supozon se edhe vetë lexuesit e tij janë duke pësuar persekutim dhe se ato do të vazhdojnë të përjetojnë akoma më shumë vuajtje në të ardhmen. “Për pak kohë”, i thotë ai lexuesve ata “duhet të vuajnë nga prova të ndryshme.” Por e gjithë kjo është për mirë, sepse përmes vënies në “provë” besimi i tyre do të rafinohet dhe do të bëhet “më i çmuar nga ari që...provohet me zjarr” (1:4-5). Prandaj ata nuk duhej të habiteshin “për provën e zjarrit që po vinte... sikur diçka e jashtëzakonshme po ndodhte, por ato duhej të “gëzoheshin” sepse ishin “pjestarë të mundimeve të Krishtit” (4:12-13).

Studiuesit kanë diskutuar gjerësisht në lidhje me atë se ç’lloj vuajtjeje kishte ndërmend autori. Pikëpamja e vjetër ka qenë se autori ishte duke u marrë me persekutimet zyrtare shtetërore, si ato që ndodhën kur perandori Neron burgosi dhe më pas ekzekutoi të krishterët në qytetin e Romës, në vitin 64 (e.s.), duke ia hedhur fajin atyre për vendosjen e zjarrit të tmerrshëm që shkatërroi pjesën më të madhe të qytetit, një zjarr që mund ta kenë vendosur vetë njerëzit e perandorit. Por gjatë njëzet viteve të kaluara apo më shumë studiuesit kanë filluar të vënë theksin se libri i 1 Pjetrit nuk flet shumë rreth persekutimit “zyrtar”, ku të krishterët arrestoheshin, hidheshin në gjyq për shkak të besimit dhe martirizoheshin. Në vend të kësaj, kundërshtimi duket se vjen nga ish miqtë dhe fqinjët, të cilët nuk kuptojnë dhe vlerësojnë stillin e ri të jetës së krishterë që ishte shumë i ndryshëm nga celebrimet e ndryshme të feve pagane (4:1-5). Domethënë, të krishterët nuk merrnin më pjesë në festivalet pagane dhe filluan të formonin shoqëritë e tyre sekrete. Paganët filluan të ishin dyshues, të nevikosur dhe urryes karshi të krishterëve, gjë e cila dërgoi në kundërshtime lokale ndaj të krishterëve, të cilat ndonjëherë bëheshin shumë të rrezikshme.

Nëse kjo është e vërtetë, atëherë është e kuptueshme që autori të vendos theksin për lexuesit e tij në faktin që është e rëndësishme për ta që të jenë të bindur nga qeverisë dhe zyrtarëve qeveritar (2:11-12), që të shfaqin sjellje të mirë ndaj të huajve (2:10), të jenë skllëvër, bashkëshorte dhe bashkëshortë të përkushtuar (2:16-3:7), që të mos bëjnë asgjë për të miratuar ndonjë kundërshtim, por të vuajnë vetëm për të bërë atë që është e drejtë (2:18). Një pjesë e mirë e këshillës dhe e inkurajimit për lexuesit e tij bazohet mbi një interpretim të sofistikuar të pasazheve kyç në Dhjatën e Vjetër, cituar, natyrisht, në gjuhën greke, në të ashtuquajturën Septuaginta (origjina legjendare e të cilës përshkruhet në letrën e falsifikuar “Letra e Aristeas”, që e kemi diskutuar në kapitullin e parë të këtij libri), siç mund të shihet edhe në pasazhet 1:24-25; 2:3, 6-9, 22, 24-25; 3:10-12).

Autori e përfundon inkurajimin për të qëndruar të palëkundur përballë vështirësisë duke treguar se ai e kishte shkruar letrën e tij “përmes Silvanit, një vëlla besnik” (d.m.th. një i krishterë i vërtetë) dhe duke dërguar përshëndetjet nga “ajo që është në Babiloni, që është zgjedhur bashkë me ju” (5:11). Studiuesit e kanë kuptuar prej kohësh se çfarë do të thotë ky informacion i fundit. Babilonia ishte qyteti që shihej si armiku përfundimtar i Zotit ndërmjet hebrenjve, duke qenë se ishte Babilonia që, në shekullin VI (p.e.s.), kishte mposhtur Judën dhe kishte shkatërruar Jeruzalemin së bashku me Tempullin e tij. Duke nisur nga fundi i shekullit të I, të krishterët dhe hebrenjtë kishin filluar të përdornin fjalët “Babiloni” si një fjalë kod për të përshkruar qytetet që ishin armiku i Zotit në kohën e tyre, qytetin e Romës, i cili, gjithashtu, kishte shkatërruar Jeruzalemin dhe Tempullin e tij në vitin 70 (e.s.) (shih, p.sh., Zbulesa 14:8; 17:5). Kështu që, autori i letrës 1 Pjetri është duke deklaruar se është duke

shkruar nga Roma. Kjo ka krejtësisht kuptim, duke pasur parasysh që traditat e mëvonshme që e shoqëronin Pjetrin me qytetin e Romës, duke e paraqitur si peshkopi dhe papa i parë.

Por, gjithashtu, tradita tregon se Pjetri u martirizua në Romë nën regjimin e Neronit, në vitin 64 (e.s.). A do të kishte kuptim që ai ta quante Romën “Babiloni” para se Roma të shkatërronte Jerusalemin në vitin 70 e.s.? Në momentin kur ndodhi katastrofa, Pjetri kishte vdekur prej kohësh. Siç ka dalë në dritë, ekzistojnë arsye të tjera, shumë të mira, për të menduar se Pjetri nuk e ka shkruar këtë libër. Ai është shkruar nga dikush që *pretendon* se është Pjetri. Para se të shpjegojmë disa prej këtyre arsyeve, së pari do t'i heshim një sy edhe letrës së dytë të Dhjatës së Re të shkruar në emër të Pjetrit.

2 Pjetri

Ka më pak debat, midis shkollarëve të Dhjatës së Vjetër, në lidhje autorësinë e 2 Pjetrit se sa për çdo libër tjetër që është konsideruar ndonjëherë si falsifikim. Kushdoqoftë ai që ka shkruar 2 Pjetrin, ai nuk ka qenë Simon Pjetri.^[10] Padyshim, autori *pretendon* se është Pjetri, madje në mënyrë më eksplicite se sa 1 Pjetri. Ai e paraqet veten si “Simeon Pjetri”^[11], një skllav dhe apostull i Jezu Krishtit”. Por, më shumë se kaq, ai deklaroi personalisht se ka qenë i pranishëm në skenën e “transfigurimit” të rrëfyer në ungjij, ku Jezusi transformohet para syve të dishepujve të tij Pjetër, Jakob dhe Gjon dhe fillon të flas me Moisiun dhe Elian, para se një zë të vij prej qielli e të thotë: “Ky është Biri im i dashur, në të jam kënaqur: dëgjojeni!”. (Mateu 17:1-8). Autori këmbëngul se ai ishte atje për të dëgjuar fjalët që ia kishte sjellë “zëri...nga lavdia e madhërishtme” (1: 15). Autori dëshiron që të mos ketë asnjë dyshim se ai është Pjetri.

Shqetësimi i tij kryesor është se ekzistojnë disa mësues të rremë në bashkësi, të cilët kanë përdredhur mesazhin e vërtetë të ungjijve. Shumica e kapitullit të dytë i kushtohet keqdashësisë së këtyre personave, pa shpjeguar asnjëherë me saktësi se çfarë mësonin ato. Ky sulm tejet qortues i quan mësimit e tyre “herezi shkatërruese” dhe thotë se ata, kundërshtarët, janë të shturur, lakmitar dhe shfrytëzues. Autori tregon se ata do të vuajnë njësoj si banorët e Sodomës dhe Gomorrës dhe njësoj si banorët e tërë botën në kohën e Noeut. Kjo do të thotë se edhe ata do të shkatërrohen. Ai i quan ata injorant dhe thotë se ata janë “janë njolla dhe fëlliqësi, dhe lëshohen pas mashtrimeve të tyre (2Pjetri 2:13). Ai thote se ata kanë sy që janë “Sytë i kanë plot me kurorëshkelje dhe nuk pushojnë së mëkatuari” (2Pjetri 2:14), etj.

Ky sulm mbi kundërshtarët, “profetët e gënjeshtërt”, përmban shumë ngjashmëri verbale me atë që mund të gjendet në librin e Judës, në Dhjatën e re. Ngjashmëritë janë kaq të shumta sa që shkollarët janë pothuajse unanim në të menduarit se autori ka marrë mesazhin e librit të Judës dhe thjesht e ka edituar paksa atë për ta përfshirë atë në librin e tij.

Përveç mësuesve të gënjeshtërt, në tekst shfaqen edhe “tallësit” që përqeshnin pikëpamjen e krishterë se Jezusi do të kthehej shpejt nga qielli për të gjykuar mbi tokë. Këto dyshues thonin që nëse supozohej se ai do të kthehej shpejt, atëherë përse nuk kishte ardhur ende? Një kohë kishte kaluar dhe çdo gjë vazhdon njësoj si më parë! Autori i 2 Pjetrit përgjigjet duke thënë se këta jobesimtarë janë injorant dhe të mashtruar dhe kanë harruar që “për Zotin një ditë është si një mijë vjet, dhe një mijë vjet si një ditë.” (3:6). Me fjalë të tjera, edhe nëse Jezusi pret për të ardhur edhe tre mijë vjet të tjera,

përsëri ai është duke ardhur “shpejt”. Në të vërtetë, Jezusi e ka shtyrë kthimin thjesht për t’i dhënë njerëzve mundësinë që të pendohen para ardhjes së shkatërrimit. Autori i 2 Pjetrit na thotë se vetë Pali ka predikuar gjera të tilla “në të gjitha letrat e tij, të cilat të paditurit dhe të paqëndrueshmit i shtrëmbërojnë, sikurse bëjnë me Shkrimet e tjera, për përhumbjen e tyre”. (3:14)

Një nga arsyet përse pothuajse të gjithë shkollarët pajtohen se Pjetri nuk e ka shkruar këtë letër është fakti se situata që presupozohet në të duket se është shumë më e vonshme në kohë. Kur Pjetri vdiq – le të themi nën vitin 64 (e.s.), në kohën e mbretërimit të Neronit – ekzistonte ende një pritshmëri e ethshme se Jezusi do të kthehej shpejt; as edhe një gjeneratë nuk kishte kaluar që nga koha e kryqëzimit. Është me kalimin e kohës që proklamimi i krishterë se gjithçka do të ndodhte “brenda kësaj gjenerate” (Marku 13:30) dhe para se të dishepujt të kenë “shijuar vdekjen” (9:1) filloi të tingëllonte si e rreme.

Në kohën kur u shkruajt 2 Pjetri, të krishterëve i duhej të mbronin veten përballë kundërshtarëve që i përqeshnin pikëpamjet e tyre se fundi do të vinte shpejt. Kësodore, “Pjetri” duhej të shpjegonte se edhe nëse fundi do të vinte pas njëmijë vjetësh, ai mund të konsidohej ende, sipas kalendarit të Zotit, sikur ishte pas qoshes, gjithçka ishte ende në program.

Mbi të gjitha, autori i 2 Pjetrit shkruante në një kohë kur ekzistonte tashmë një përmbledhje e letrave të Palit ishte në qarkullim dhe këto letra konsideroheshin të barabarta me “Shkrimet” e Dhjatës së Vjetër (3:14). Kjo nuk mund të ketë ndodhur gjatë jetës së Palit^[12] dhe tradita e hershme e krishterë tregon se si Pjetri ashtu edhe Pali u vranë gjatë mbretërimit të Neronit.

Këto janë disa nga arsyet për të menduar se 2 Pjetrit pothuajse pa dyshim nuk mund të jetë shkruar nga Pjetri.^[13] Ekziston edhe një arsye tjetër e fortë, ekzitojnë prova mëse të forta që tregojnë se Pjetri nuk dinte të shkruante.

Simon Pjetri, Palestina e lashtë, të shkruarit dhe leximi.

Çfarë dimë ne për aftësinë për të lexuar dhe shkruar në botën e lashtë, veçanërisht në palestinën rurale, ku Simon Pjetri kishte lindur dhe ishte rritur? Studiuesit e antikitetit janë treguar të zellshëm, gjatë njëzet e pesë vjetëve të kaluara apo më shumë, në përpjekjen për të kuptuar çdo aspekt të shkrim këndimit dhe edukimit në periudhën e lashtë. Në atë që sot konsiderohet studimi klasik në lidhje me këtë çështje, libri i vitit 1989 me titull “Ancient Literacy”, Eilliam Harris, profesor i historisë së lashtë në “Columbia University”, tregon se supozimet moderne rreth shkrim e këndimit janë thjesht të pazbatueshme për kohërat e lashta.^[14] Sot, në Amerikën moderne, ne jetojmë në një botë ku pothuajse çdo fëmijë shkon në shkollë dhe mëson të lexoj dhe të shkruaj. Ne e dimë se pothuajse çdokush mund të lexoj faqen sportive në gazetë dhe të kopjoj një faqe të një novele, në se dëshirojnë ta bëjnë një gjë të tillë. Por fenomeni i shkrim e këndimit në masë është një fenomen tërësisht modern. Para revolucionit industrial, shoqëritë nuk kishin asnjë arsye detyruese për të investuar sasi të mëdha parash dhe burime të tjerë për të krijuar një shoqëri pa analfabetizëm. Vetëm me ardhjen e botës industriale një gjë e tillë u bë e dëshirueshme dhe e realizueshme.

Harris argumenton se në botën e lashtë, në kohërat më të mira, vetëm 10% e popullsisë ishte

mjaftueshëm e arsimuar. Me shprehjen “kohërat më të mira” ai kishte për qëllim Athinën, e cila ishte një qendër dijeje, në kulmin e fuqisë së saj intelektuale, gjatë periudhës së Sokratit dhe Platonit (shekulli IV-V p.e.s.). Shumica e këtij 10% ishin burra, siç mund të pritej në një shoqëri tejet patriarkale. Të gjithë ata i përkisnin shtresës së lartë, elitës socio-ekonomike, të cilët kishin kohën dhe paratë (në fakt, prindërit e tyre kishin paratë) për të përballuar edukimin. Njerzit e shtresave të ulta nuk mësonin si të lexonin, lëre më pastaj të shkruanin. Shumica e njerëzve në botën e lashtë i përkiste shtresës së ulët (për habinë e të shumtëve, “klasa e mesme” është një tjetër shpikje e revolucionit industrial; në botën e lashtë pothuajse çdokush ishte i shtresës së lartë ose të ulët, i shtresës shumë të lartë ose shumë të ulët). I vetmi përjashtim ishin skllëverit, të cilët i përkisnin në mënyrë të natyrshme klasës shumë të ulët, por që ndonjëherë merrnin edukim me shpenzimet e padronëve të tyre, në mënyrë që ata të mund të kryenin detyrat e shtëpisë që kërkonin shkathtësitë e ofruar nga shkrim e këndimi, si p.sh. menaxhimi i financave të shtëpisë, mbajtja e korrespondencës ose mësimi i fëmijëve.

Kur them që vetëm disa njerëz mund të lexonin, “lëre më pastaj të shkruanin”, unë dëshiroj të sinjalizoj diçka tjetër tejet domethënëse rreth botës së lashtë. Kur njerëzit e klasës së lartë ishin të edukuar, leximi dhe shkrimi mësoheshin si dy aftësi të ndryshme.^[15] Sot ne e mësojmë leximin dhe shkrimin së bashku dhe në mënyrë të natyrshme e marrim për të mirëqenë se nëse njerëzit dinë të lexojnë, atëherë ata duhet domosdoshmërisht të dinë edhe të shkruajnë – jo domosdoshmërisht një novelë, por së paku një letër. Por kjo vjen si shkak i mënyrës se si e kemi ngritur sistemin tonë edukativ. Në mësimin e të lexuarit nuk ka asgjë të qenësishme që mund të të mësoj domosdoshmërisht se si të shkruash. Unë e di këtë më së miri personalisht. Unë mund të lexoj greqisht, hebraisht, frëngjisht, gjermanisht dhe një sërë gjuhësh të tjera, por nuk jam i aftë të shkruaj qoftë edhe një letër në këto gjuhë. Unë kam mësuar se si t'i lexoj këto gjuhë në shkollë të mesme, kështu që mund të lexoj dokumente të lashta në gjuhën e tyre origjinale dhe studimet moderne në gjuhët evropiane. Por, unë nuk kam mësuar asnjëherë se si t'i shkruaj ato.

Shumica e njerëzve në botën e lashtë nuk ishte e aftë të lexonte dhe ata që mund të lexonin shpesh nuk dinin të shkruanin. Në këtë rast me fjalën “shkruaj” unë dua të them se shumica e njerëzve – edhe ndonëse mund të kopjonin fjalë – nuk ishin në gjendje të formonin një fjali, për të mos folur për një traktat të mirëargumentuar. Përkundrazi, njerëzit që mundeshin të shkruanin një ese etike, një diskutim të kulturuar filozofik, apo një traktat fetar, ishin tejet të edukuar dhe tepër të rrallë. Dhe kjo gjendje ishte kështu në rastet më të mira. Vërtet shumë pak njerëz ishin të aftë të përmbushnin këto aftësi në një gjuhë të ndryshme nga ajo me të cilën ishin rritur. Unë nuk po them se vetëm 1% e popullatës ishte e aftë ta bënte një gjë të tillë, por po them se më pak se 1% e popullatës mund ta bënte këtë gjë.

Ndonjëherë mendohet se Palestina përbënte një përjashtim dhe se në Palestinë djemtë hebrenj mësonin të gjithë të lexonin, kështu që ata mund ta studionin shkrimin e shenjtë, e duke qenë se ata mund të lexonin atëherë me gjasë dinin edhe të shkruanin. Mbi të gjitha, argumentohet se në Palestinë shumica e njerëzve të rritur ishin dygjuhësh ose madje edhe tregjuhësh, të aftë të lexonin hebraisht, të flisnin gjuhën lokale aramaike dhe të komunikonin mirë në gjuhën greke, e cila ishte gjuha e perandorisë. Megjithatë, studimet e ditëve tona në lidhje me shkrim e këndimin në Palestinë kanë treguar në mënyrë bindëse se asnjë prej këtyre pohimeve nuk është i vërtetë.

Kërkimi më i plotë, më me themel dhe më me ndikim në lidhje me shkëm e këndimin në Palestinë gjatë periudhës së Perandorisë Romake është ai i shkruar nga Catherine Hezser.^[16] Pasi ka shqyrtuar të gjitha evidencat, Hezser ka arritur në përfundimin se në palestinën romake, hamendësimi më i mirë është se diku rreth 3% e popullsisë mund të lexonte dhe se shumica e këtyre ndodhej në qytetet e

mëdha. Shumica e njerëzve jashtë zonave urbane vështirë se shihnin ndonjëherë ndonjë tekst të shkruar. Disa qytetete dhe fshatra të vogla mund të kenë pasur një nivel shkrim e këndimi diku tek 1%. Mbi të gjitha, këto njerëz që dinin shkrim e këndim ishin pothuajse gjithnjë pjesë e elitës të klasës së lartë. Ata që mësonin të lexonin, mësonin të lexonin hebraisht (jo greqisht).

Sërish, kishte më shumë njerëz që dinin të lexonin se sa të shkruanin. Njerëzit që dinin të shkruanin ishin kryesisht priftërinjtë. Në të vërtetë, për tërë shekullin e I (e.s.) (koha e Jezusit dhe Simon Pjetrit), ne jemi të sigurtë vetëm për dy autorë në Palestinë që prodhuan vepra letrare (d.m.th. kompozime të kulturuara të ndryshme nga dokumentet e taksave, aktet në lidhje me tokat, ose certifikatat e martesës, etj.): këto ishin historiani hebre Jozef Flavi dhe një burrë i quajtur Justus nga Tiberi. Në ditët tona, ne zotërojmë ende shkrimet e Jozefit, por jo ato të Justusit. Të dy këto njerëz ishin në shtresën e lartë të shoqërisë dhe të dy ishin në mënyrë të jashtëzakonshme shumë të kulturuar. Për tërë shekullin e I (e.s.) ne nuk jemi në dijeni të asnjë autori tjetër. A i përkiste Pjetri të njëjtës klasë si Jozefi dhe Justusi? Jo, aspak.

Po për sa i përket edukimit grek, në tokën e lindjes dhe rritjes së Pjetrit? Ndonjëherë është supozuar se duke qenë se Galilea, pjesën veriore të së cilës ne e njohim si Izrael, quhej nganjëherë “Galilea e xhentilëve”, në kohën e Jezusit dhe Pjetrit ajo duhej të ishte e mbizotëruar nga xhentilët. Sipas një logjike të zakonshme, nëse në Galile ka pasur shumë xhentilë, ata duhet të kenë folur greqisht; kështu që në mënyrë që të kuptoheshin më njeri-tjetrin çdokush duhet të ketë folur greqisht. Siç është parë nga studimet, as kjo nuk është e vërtetë.

Studimet e fundit më të thelluara në lidhje me xhentilët në Galile janë kryar nga studiuesi amerikan Mark Chancery.^[17] Chancery ka studiuar çdo gjetje arkeologjike nga Galilea, që i përket periudhës së shekullit të I, ka lexuar çdo copëz shkrimi nga periudhat që kanë rëndësi në këtë çështje dhe arrin në një përfundim përfundimtar: xhentilët në Galile ishin pothuajse tërësisht të vendosur në dy qytetet kryesore, Seforis dhe Tiberias. E gjitha pjesa tjetër e Galilesë ishte kryesisht e përbërë nga hebrenj. Duke qenë se shumica e Galilesë ishte rurale, jo urbane, pjesa dërrmuese e hebrenjve nuk ka pasur asnjë kontakt me xhentilët. Mbi të gjitha, greqishtja nuk flitej gjerësisht, e jo më normalisht. Pjesa dërrmuese e hebrenjve fliste aramaikisht dhe nuk kishin asnjë lehtësi në të folurin e gjuhës greke.

Si e ndikojnë të gjitha këto gjetje pyetjen tonë nëse Pjetri ka shkruar 1 ose 2 Pjetrin, ose ndonjë libër tjetër? A i përkiste Pjetri shtresës së lartë të elitës së kulturuar të Palestinës, e cila mund të hartonte letra në formë eseje në gjuhën greke? Përveç rrëfimeve legjendare që kam përmendur, gjithçka që njohim për jetën e Pjetrit vjen nga Dhjata e Re. Kryesisht, ajo që dimë rreth tij është se para se të ishte një ndjekës i Jezusit ai ishte një peshkatar nga Kapernaumi në Galile.

Në mënyrë që të vlerësojmë aftësitë gjuhësore të Pjetrit, vendi më i mirë për t’ia nisur studimit është Kapernaumi. Një përmbledhje e plotë e asaj që dimë në lidhje me Kapernaumin e kohës së Pjetrit është dhënë nga arkeologu i Palestinës, Jonathan Reed.^[18] Në bazë të gërmimeve arkeologjike dhe burimeve historike, është e qartë se Kapernaumi ishte një fshat historikisht i parëndësishëm. Ai nuk është përmendur në asnjë burim të lashtë para kohës së ungjijve. Ai pothuajse nuk është përmendur fare edhe pas shkrimit të ungjijve. Në kohën e Jezusit, Kapernaumi mund të ketë pasur dikur rreth gjashtëqind dhe njëmijë e pesëqind banorë, le të themi një mijë banorë.

Gërmimet arkeologjike nuk kanë zbuluar asnjë evidencë të ekzistencës së çfarëdolloj ndërtese publike, të tilla si dyqane apo ambiente magazinimi^[19]. Tregu për të blerë ushqime dhe gjera të tjera të domosdoshme duhet të ketë qenë me tenda apo baraka, në zona të hapura publike me rrugë të

pashtruara. Qyteti i Galilesë nuk ishte në asnjë itinerar kryesor tregtie ndërkombëtare. Rrugët romake në atë zonë datojnë qindra vjet pas jetës së Pjetrit. Në qytet, nuk ka asnjë gjurmë të ndonjë popullate pagane apo xhentile. Në asnjë prej ndërtesave të qyteteve nuk gjendet ndonjë mbishkrim, i çfarëdo lloji qoftë. Reed mbërrin në përfundimin se banorët e Galilesë ishte pothuajse pa dyshim “kryesisht analfabetë”. Arkeologët nuk kanë gjetur asnjë strukturë apo material ndërtimor që të shoqërohej me elitat sociale të shekullit I (e.s.), p.sh. sipërfaqe të suvatuara, afreske dekorative, mermer, mozaikë, tjegulla qeramike të kuqe. Shtëpitë ndërtoheshin në mënyrë të parafinuar duke përdorur kryesisht bazalt guri dhe baltë ose argjila përdorej për të mbushur boshllëqet; me shumë mundësi ata kishin çati kashte.

Me pak fjalë, qyteti i Pjetrit ishte një fshat i humbur hebre i përbërë nga punëtorë krahu, të cilët nuk ishin të arsimuar. Gjithkush fliste aramaikisht. Asgjë nuk sugjeron se ndokush mund të fliste greqisht. Asgjë nuk sugjeron se ndokush në qytet mund të shkruante. Si një peshkatar, që i përkiste klasës së ulët, Pjetri duhet të ketë filluar punë që në djalëri dhe të mos ketë pasur asnjëherë mundësinë për të shkuar në shkollë. Në të vërtetë, ndoshta në Galilea nuk ka ekzistuar asnjë shkollë; nëse ka pasur ndonjë shkollë me shumë gjasa ai nuk e ka frekuentuar atë. Nëse e ka frekuentuar kjo ka qenë në mënyrë që të merrte trajnim fillestar rreth leximit të hebraishtes. Por, pothuajse me siguri kjo nuk ka ndodhur asnjëherë. Pjetri ishte një fshatar analfabet.

Kjo nuk duhet të na habisë, vërtet. Sepse siç është bërë e qartë, në lidhje me nivelin e edukimit të Pjetrit ekzistojnë evidenca në Dhjatën e Re. Sipas Akteve 4:13, Pjetri dhe shoku i tij Gjoni, edhe ky një peshkatar, ishin *agrammatoi*, një fjalë greke që literalisht do të thotë “të pamësuar”, d.m.th. “analfabetë”.

A është e mundur, pra, që Pjetri të ketë shkruar 1 dhe 2 Pjetrin? Ne i kemi arsyet e forta që na shtyjnë të besojmë se ai nuk e ka shkruar 2 Pjetrin dhe disa nga arsyet që na shtyjnë të mendojmë se ai nuk ka shkruar as 1 Pjetrin. Por, është shumë e mundshme që në realitet ai të mos ketë qenë aspak i aftë të shkruante. Duhet të përmend, se libri i 1 Pjetrit është shkruar nga një i krishterë greqishtfolës shumë i shkolluar dhe i edukuar, i cili është ngushtësisht i familjarizuar me shkrimet hebraike dhe përkthimin e tyre grek, Septuaginta. Ky nuk është Pjetri.

Natyrisht, është teorikisht e mundur që pas ringjalljes së Jezusit, Pjetri të ketë vendosur të shkollohet. Në këtë skenar të përfytyruar (për të mos thënë imagjinar), ai ka mësuar alfabetin e tij, si të shqiptoj rrokjet e më pas fjalët, si të lexoj dhe të shkruaj. Më pas ai ka marrë orë mësimi në gjuhën greke, e ka mësuar greqishten si një gjuhë e huaj dhe ka filluar të memorizoj pjesë të mëdha të Septuagintës. Më pas ai ka ndjekur orën e kompozimit në gjuhën greke dhe ka mësuar si të kompozoj fjali të ndërlikuara dhe të fuqishme nga ana retorike. Më pas nga fundi i jetës ai ka shkruar 1 Pjetrin.

A është i besueshëm ky skenar? Përveç faktit që nuk dimë që në antikitet të ketë pasur ndonjë klasë për “mësimin e të rriturve” – nuk ekziston asnjë evidencë se ato kanë ekzistuar – unë mendoj se shumica e njerëzve të arsyeshëm do të arrinë në përfundimin se me shumë gjasë, pasi besoi se Jezusi ishte ngjallur së vdekuri, Pjetri ka pasur gjëra të tjera në mendje dhe ndër duar. Me shumë mundësi ai nuk ka menduar asnjëherë, qoftë edhe për një moment, që të mësoj se si të bëhet një autor grek i shkathët nga ana retorike.

Disa studiuesë kanë sugjeruar se Pjetri nuk e ka shkruar *drejtpërdrejt* 1 Pjetrin (siç e kam treguar, pothuajse askush nuk mendon se ai ka shkruar 2 Pjetrin), por ai e ka shkruar atë në mënyrë *indirekte*, p.sh. duke ia diktuar letrën një skribi. Disa kanë vërejtur se letra është shkruar “përmes Silvaniit” (5:10)

dhe kanë menduar se ndoshta Silvani ka shkruar mendimet e Pjetrit, në emër të tij. Unë e trajtoj këtë çështje, nëse kanë shkruar ndonjëherë sekretërat apo skribët letra të tilla në formë eseje, në kapitullin e katërt të këtij libri. Përgjigjja është, “pothuajse pa dyshim jo”. Por, hë për hë, unë mund të them së paku disa fjalë në lidhje me çështjen e 1 Pjetrit.

Së pari, në ditët tona studiuesit pranojnë gjerësisht se kur autori tregon se ai ka shkruar librin “përmes Silvanit”, në të vërtetë ai nuk është duke treguar emrin e sekretarit të tij, por personin i cili ishte duke ia dërguar letrën marrësve. Autorët që përdornin sekretarë nuk i referoheshin atyre në këtë formë.

Po, përse të mos supozojmë se Pjetri ka përdorur dikë tjetër, përveç Silvanit, si një sekretar? Do të ishte e dobishme të mundoheshim të përfytyronim se si supozohet të funksionoj saktësisht kjo teori. Pjetri nuk mund t’ia ketë *diktuar* këtë letër në greqisht një sekretari, aq më pa ta ketë shkruar vetë atë. Kjo do të kishte kërkuar që ai të ishte përsosmërisht i rrjedhshëm në gjuhën greke, të ketë zotëruar teknika retorike në gjuhën greke dhe të ketë qenë i familjarizuar me shkrimet hebraike në gjuhën greke. Asnjë prej këtyre mundësive nuk është e besueshme. Po ashtu, nuk mund të mendohet lehtësisht se ai e ka diktuar letrën në aramaikisht dhe sekretari e ka përkthyer në greqisht. Letra nuk duket si një përkthim grek i një origjinali aramaik, por si një kompozim origjinal grek me zbukurime retorike greke. Mbi të gjitha, letra presupozon njohjen e Dhjatës së Vjetër në përkthimin e saj grek, kështu që personi që ka kompozuar letrën (qoftë në mënyrë orale apo me shkrim) duhet të ketë njohur Shkrimin e shenjtë në përkthimin e tij grek.

A është e mundur që Pjetri historik ta ketë udhëzuar dikënd që të shkruaj një letër, t’i ketë thënë pikat themelore se çfarë duhet të thotë dhe t’ia lej atij në dorë hartimin e saj? Ndaj kësaj pyetjeje ka dy përgjigje. Së pari, nëse në realitet dikush tjetër e ka shkruar në realitet letrën, atëherë autori i letrës duhet të jetë *ai* person, dhe jo Pjetri. Por, personi tjetër nuk është përmendur asnjëherë. Edhe në letrat e Palit që janë në bashkëautorësi (pothuajse në të gjitha ato), ai i përmend të tjerët, ndonëse me gjasë ai i ka shkruar vetë ato. Ndërsa, në rastin tonë mendohet se Pjetri as nuk i ka shkruar vetë. Duhet kujtuar se ka arsye të forta për të menduar që letra është shkruar pasi Pjetri kishte vdekur, duke qenë se ajo aludon për shkatërrimin që Roma i bëri tempullit të Jerusalemit, në vitin 70.

Por, arsye më e fortë është kjo. Ku mund të gjejmë në botën e lashtë diçka të ngjashme me këtë situatë hipotetike të dikujt që shkruan një letër në formë eseje për dikë tjetër dhe i vendos asaj emrin e tjetërkujt – emrin e personit që *nuk* e ka shkruar letrën – në vend të emrit të tij? Për sa di unë, nuk ekziston asnjë rast i vetëm të një procedure të tillë që të jetë dëshmuar në lashtësi, apo të ndonjë diskutimi, në ndonjë burim të lashtë, ku kjo të konsiderohet një praktikë legjitime. Një gjë e tillë nuk është diskutuar asnjëherë.

Megjithatë, ekzistojnë boll raste të një tjetër fenomeni. Ky është fenomi i autorëve të krishterë që shkruan vepra të falsifikuara, duke pohuar në mënyrë të gënjeshtërt se janë shkruar nga një person i famshëm. Studuesit e lashtë do ta kishin quajtur një libër të tillë një shkrim “të atribuuar në mënyrë të gënjeshtërt”, një “gënjeshtërt”, një fëmijë i “paligjshëm”. Njerëzit modern do ta kishin quajtur thjesht falsifikim.

Përktheu: Rezart Beka

Shënime

- [1] Në tregimin e plotë, babai i Xhorxh Uashingtonit ndjehet kaq krenar për faktin që i biri tregoi të vërtetën edhe përballë rrezikut të mundshëm sa që ai e mori atë në krah dhe e lavdëroi tej mase.
- [2] Ekzistojnë një sërë librash interesant në lidhje me gënjeshtren, që janë të përshtatshëm edhe për publikun e gjerë. Një prej librave më me ndikim në këtë aspekt është ai i Sissela Bok, "Lying: Moral Choice in Public and Private Life", botimi i tretë, (Neë York: Vintage, 1999).
- [3] Për gënjeshtren në lashtësi shih veçanërisht përmbledhjen e eseve në Christopher Gill dhe T.P. Äiseman, eds., "Lies and Fiction in the Ancient World" (Austin: University of Texas Press, 1993).
- [4] Përrjashtim mund të bëjnë disa lloje fantazish dhe trillimi fantastiko-shkencor, por edhe në këtë rast besueshmëria është një tipar i rëndësishëm. Novelat postmoderne, për habinë e askujt, janë krejt tjetër gjë.
- [5] Polybius, "Histories" 2.56.10-12; përkthyer nga W. R. Paton, Loeb Classical Library" (Neë York: Putman, 1922).
- [6] Për një përkthim në gjuhën angleze të këtyre historive, të cilat bashkarisht njihen si "Veprat e Pjetrit" shih J.K. Elliot, "The Apocryphal Neë Testament" (Oxford: Clarendon, 1993), f. 390-430. Si edhe Äilhelm Schneemelcher, "New Testament Apocrypha", përkthyer nga R. McL. Wilson, nga botimi I gjashtë gjerman, 2 vëllime. (Louisville, KY: Äestminster John Knox, 1991-92), vëllimi 2, f. 271-321.
- [7] Për një diskutim të librit, që përfshin prova se nuk ishte shkruar nga Pjetri, shih J. H. Elliott, "Peter, First Epistle of", Anchor Bible Dictionary" (New York: Doubleday, 1992), vëll. 5: 269-78.
- [8] Natyrisht, Jezusi mund të ketë folur aramaikisht. Fjala aramaike për "gurin" është Kefas, kjo është forma në të cilën shfaqet emri i Pjetrit në formën e tij aramaike. Unë nuk jamë duke thënë se rrëfimi i Mateut është historikisht i saktë në përshkrimin që i bën Pjetrit si "guri" i Kishës, por unë mendoj se është tejet e mundur që Jezusi ti ketë vënë, gjatë jetës së tij ministrore, emrin "Guri" dishepullit Simon.
- [9] Nuk duhet kundërshtuar fakti se Pjetri nuk e ka parë, në të vërtetë, kryqëzimin e Jezusit, prandaj nuk ishte një "dëshmitar" i vuajtjeve të tij. Kushdo që ka shkruar këtë libër, pothuajse me siguri nuk i ka pasur ungjijtë për t'i lexuar. Ne nuk mund ta dimë se çfarë mendonte ai për përfshirjen e Pjetrit në çastet e fundit të Jezusit.
- [10] Për një diskutim të këtij libri, në të cilin tregohen provat që ai nuk është shkruar nga Pjetri shih J. H. Elliot, "Peter, Second Epistle of", Anchor Bible Dictionary, vëll. 5:282-87.
- [11] Simeon duket se është forma hebraike e emrin "Simon". Arsyeja përse autori e ka përzier hebraishten (Simeon në vend të Simon) me greqishten (Pjetër në vend të aramaikishtes Kefas) mbetet një enigmë.
- [12] Vetë Pali nuk mendonte se po shkruante "shkrim të shenjtë". Ai i po i shkruante letra personale kishave të tij dhe kështu e kuptuan edhe anëtarët e kishave të tij, si korrespondencë personale. Vetëm

më pas, pas jetës së Palit, kishat dhe individë të ndryshëm i mblodhën këto letra dhe filluan ti konsideronin si shkrim i shenjtë. Për një koment të thellë mbi përmbledhjet e hershme të letrave të Palit shih Harry Gamble, "Books and Readers in the Early Church" (New Haven, CT: Yale University Press, 1993), f. 58-65.

[13] Ekzistojnë edhe arsye të tjera për të supozuar që Pjetri nuk e ka shkruar këtë letër. Në pasazhin 3:2 autori i letrës bën një gabim dhe thotë "apostujt tuaj", njësoj sikur ai të mos ishte një prej tyre. Mbi të gjitha, autori përdor librin e Judës, kështu që duhet të jetë shkruar më vonë se sa letra e falsifikuar. Ai njih 1 Pjetrin (duke qenë se ai i referohet këtij libri si letra e tij e "dytë"), gjë e cila, siç do të argumentoj tani më në detaje, nuk mund të ketë qenë shkruar nga Pjetri, por është shkruar më vonë, së paku pas rënies së Jeruzalemit, në vitin 70 (e.s.)

[14] William Harris, "Ancient Literacy" (Cambridge, MA: Harvard University Press, 1989).

[15] Midis shume studimeve të shkëlqyera në lidhje me sistemet e lashta të edukimit shih veçanërisht studimin e Raffaella Cribbiore, "Gymnastic of the Mind: Greek Education in Hellenistic and Roman Egypt" (Princeton, NJ: Princeton University Press, 2001).

[16] Catherine Hezser, "Literacy in Roman Palestine" (Tübingen: Mohr Siebeck, 2001).

[17] Mark Chancery, "The Myth of a Gentile Galilee" (Cambridge: Cambridge University Press, 2002); shih edhe sutimin e tij të mëvonshëm "Greco-Roman Culture and the Galilee of Jesus" (Cambridge: Cambridge University Press, 2005).

[18] Jonathan Reed, "Archeology and the Galilean Jesus" (Harrisburg, PA: Trinity Press International, 2000), f. 140-69.

[19] Sinagoga e famshme që në ditët tona turistët e shohin në sitin arkeologjik është ndërtuar shekuj më vonë.

Date Created

01/08/2022

Author

erasmusi